



MEETING MINUTES

# **ZBARDHJE E MINUTAVE NGA TAKIMI I ANTARËVE TË BORDIT EITI**

24 JANAR 2020

12:00 AM

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

LIST PREZENCA

---

Z. GENCI TËRPO, **DREJTUES I SEKRETARIATIT KOMBËTAR EITI**

ZNJ. ENTELA MUHA, **MINISTRIA E DREJTËSISË**

Z. ROBERT BESHELLO, **AGJENSIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE**

ZNJ. ANILA HAJNAJ, **SHOQËRIA CIVILE**

Z. SAMI NEZA, **SHOQËRIA CIVILE**

ZNJ. OLA MITRE **SHOQËRIA CIVILE**

Z. LORENC GORDANI, **SHOQËRIA CIVILE**

Z. PËRPARIM ALIKAJ, **FIAA**

Z. BILAL KOÇI, **SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR**

Z. AGIM NASHI, **ENTI RREGULLATOR I ENERJISË**

PJESËMARRËS TË TJERË

---

Z. LLUKA GJERGO, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

ZNJ. ANISA DEDA, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

ZNJ. EMILIANA KOLA, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

ZNJ. ARLINDA RUMBULLAKU, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

Z. GLEDIS KALEMI, **ENTI RREGULLATOR I ENERJISË**

FOTO NGA TAKIMI I MSG-së

---



**Z. GENCI TËRPO** Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në mledhjen e sotme të MSG-së. Për ata që nuk më njohin, unë jam Genci Tërpo, Drejtuesi i ri i Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Kam rreth 50 ditë që e kam marrë këtë detyrë dhe disa prej jush unë i njoh por do ju kërkoja dhe një prezantim të gjithësecilit. Pas prezantimit unë do bëj një raportim të punës që kemi bërë këto ditë që unë kam marrë detyrën dhe duke vijuar më pas me pikat e axhendës. Për çdo mendim që do keni, unë jam i hapur të diskutojmë dhe t'ju dëgjoj të gjitha komentet e juaja duke reflektuar çdo ndryshim që ju e çmoni që është e nevojshme në shërbim të punës. Ndërkohë jemi duke pritur edhe Zëvendësministrin i cili nëse do ketë kohë do të bashkohet këtij takimi.

- Bëhet prezantimi i anëtarëve pjesëmarrës në takim.

**Z. GENCI TËRPO** Pikë së pari më lejoni t'ju informoj për disa veprime që ne kemi ndërmarrë. Siç ju e dini EITI për një periudhë të caktuar kohe ka pasur disa problematika. Problematika që lidheshin kryesisht me mungesën e drejtuesit duke sjellë një situatë që nuk është shumë e mirë për institucionin. E thënë ndryshe EITI ka pasur një plan aktivitetesh që duhet të kishte zhvilluar brënda një afati të caktuar të cilat fatkeqësisht nuk janë realizuar dhe ju e dini çfarë ndodhë në rastet kur ne nuk jemi korrekt për sa i përket zbatimit të detyrimeve që kemi në përputhje me Standartin që kërkohet dhe nga EITI Ndërkombëtar. Unë kam filluar punë ditët e tërmetit dhe patëm një situatë të përgjithshme siç ndodhi në të gjithë Shqipërinë ku puna për pak ditë edhe tek ne u pezullua, megjithatë vazhduam në mënyrë të menjëhershme të kryenim ato veprime të cilat përbëjnë dhe punën tonë, ku një prej tyre ishte dhe përzgjedhja e Administratorit të Pavarur për sa i përket përgatitjes së Raportit EITI 2017-2018. Arritëm që ta realizonim këtë procedurë brënda vitit në një kohë shumë të shkurtër dhe Administratori i Pavarur ka filluar punën për të realizuar Raportet e dy viteve. Favori që kemi është që të realizojmë një raport për dy vite, ndryshe nga raportimet që bëheshin përpara me një raport në vitë por kuptohet jemi në mungesë të kohës, një raportim i cili duhet të ishte bërë që në fundin e vitit 2019.

Megjithatë shpresojmë që organet që vendosin për sa i përket veprimtarisë EITI në Shqipëri të na japin mundësinë dhe kohën që ne të kemi mundësi të realizojmë këtë raportim brenda muajit Prill të këtij viti. Kemi përcaktuar një periudhë 3-mujore për të realizuar dy raporte në mënyrë që të kapim kohën e humbur. Një aktivitet tjetër që është shumë i rëndësishëm, është dhe përzgjedhja e Administratorit për publikimin e Pronarëve Realë të industrisë nxjerrëse në Republikën e Shqipërisë. Edhe në këtë fazë kam konstatuar se ka patur vonesë dhe natyrisht që do të mundohemi të bëjmë maksimumin që ta realizojmë këtë brenda një afati shumë të shkurtër, këtë vit. Natyrisht që realizimi i aktiviteteve lidhet ngushtësisht dhe me mundësitë që na janë ofruar nga Banka Botërore për të përdorur fondet e tyre për një periudhë të caktuar. Shpresojmë që Banka Botërore do të jetë e mirëkuptueshme po dhe Ministria e Financave do të bëjë të mundur që të zgjatet afati i përdorimit të grantit në mënyrë që dhe ne të kemi mundësi të vazhdojmë me aktivitete e tjera të planifikuara edhe më parë. Në Axhendën që ne ju kemi paraqitur, kemi specifikuar edhe Planin e Punës që ne kemi për këtë vit. Unë besoj që ju e keni parë. Nga ana tjetër po ju raportoj se kam punuar gjatë me EITI Ndërkombëtar këto pak ditë duke lobuar që nga momenti që kam marrë detyrën dhe besoj se nuk do të kemi penalizim nga ana e tyre në këtë drejtim. Nëse keni ndonjë pyetje për sa i përket veprimtarisë së Sekretariatit mund të më drejtoheni.

**Z. SAMI NEZA** Po bëj një pyetje para kohe, e cila mund të diskutohet edhe më vonë, në lidhje me ligjin e transparencës....me sa kam parë ky ligj, po diskutohet te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe do kërkoja që ndërkohë që po diskutohet në Ministri të na jepet edhe ne për mendim. Ne kemi pasur një draft të këtij ligji.

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Sami, draft ligji që keni marrë ju është i njëjti me atë që po diskutohet në Ministri.

**Z. SAMI NEZA** Është i njëjti? Nuk ka ndryshime?

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Po, është i njëjti draft ligj që ka përgatitur konsulenti i kontraktuar në atë kohë dhe që e kemi diskutuar edhe në MSG.

**Z. SAMI NEZA** Besoj është planifikuar që edhe ne anëtarët e MSG-së të japim një mendim për draft ligjin.

**Z. GENCI TËRPO** Në momentin që draft ligji është në Minsitrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, i dërgohet të gjitha grupeve të interesit. Nga sa jam informuar ky draft ju është përcjellë për të dhënë mendime më parë.

**ZNJ. ANISA DEDA** Ju lutem, kam diçka për të shtuar. Është i njëjti projektligj, studimi i të cilit ka përfunduar në Janar të 2017 dhe ne jemi mbledhur në një workshop nga vetë kompania që e bëri studimin dhe draftoi projektligjin dhe e prezantoi para të gjithë antarëve të MSG-së. Ju ndoshta dhe nuk e mbani mend por u la rreth një muaj kohë për të bërë komente MSG-ja dhe të gjitha palët e përfshira në këtë Bord dhe ne më pas e kemi kaluar në Ministri për tu miratuar dhe për tu dërguar më pas tek Ministritë e linjës për të dhënë komentet e tyre rreth projekt ligjit. Por nëse ju kërkoni që ne ta rishpërndajmë, ne e rishpërndajmë nuk përbën problem por le të themi që ka mbi një vit që është brenda Ministrisë në Drejtoritë përkatëse, nga MSG-ja ka dalë që në janar të 2017 ky studim dhe ky projekt ligj. Ju i keni bërë komentet tuaja por nëse ju kërkoni ne e rishpërndajmë por është në një fazë tjetër tani.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Bëhen publike komentet e të gjithë institucioneve përkatëse? Sepse ne duhet të dimë se çfarë bëhet.

**ZNJ. ANISA DEDA** Ne mund ta rishpërndajmë meqë ka dhe anëtarë të rinj.

**ZNJ. OLA MITRE** Nuk është vetëm tek pjesa e anëtarësisë por ka edhe zhvillime të reja sepse paralelisht me këtë ligj është edhe Ministria e Financave që po zhvillon një tjetër ligj që ka të bëjë prap me Përfituesit Realë dhe ndoshta Ministritë po shikojnë mundësitë që ti bashkojnë këto dy ligje me njëri tjetrin dhe

praktikisht dhe normalisht do ketë ndryshime edhe tek drafti që është propozuar nga EITI.

**ZNJ. ANISA DEDA** Këtë gjë po bëjmë dhe ne nga departamenti ligjor brenda Ministrisë domethënë kërkojmë që ato të hedhin mendimet e tyre dhe të bëjnë këto rakordimet

**ZNJ. OLA MITRE** Të bëhet një rakordim. Pra ne nuk duhet të shkojmë me një draft më vete por të shikohet mundësia që ato të integrohen dhe të dali një ligj i vetëm

**Z. LLUKA GJERGO** Mendoj që mbas mendimeve apo sygjërimeve që do të bëjnë Drejtoritë apo edhe Institucionet e tjera, të diskutohet edhe njëherë këtu në MSG, drafti i finalizuar me mendimet e institucioneve të tjera.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Këtë sygjerova edhe unë sepse ne jemi tryeza që lidhemi me EITI më shumë

**Z. SAMI NEZA** Edhe pse si procedurë ne e kemi kaluar, hapësirë për të ndërhyrë në ligj ka përsëri. Edhe unë nuk mbaj mend të kemi dhënë mendimin tonë si shoqëri civile. Të na jepet mundësia ta rishikojmë edhe njëherë sepse siç e përmendi edhe Ola Mitre mund të ketë edhe zhvillime të reja. Sepse edhe deri ditën e fundit që ato miratohen në komision mund të ketë ndryshime.

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Ky draft ligj është i njëjti dhe nuk ka ndonjë gjë të re nga ajo që ju tashmë keni parë.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Unë kam biseduar edhe personalisht me Drejtorin e EITI pardje dhe situata jonë ka vonesa por me ardhjen e Drejtuesit të ri gjërat kanë ndryshuar shumë shpejt për mirë.. Ashtu siç bëmë ne thirrje si shoqëri civile në shtator që të merreshe në dorë situata pasi ishim shumë të vonuar. Situata është që ne duhet të punojmë fort që të kapim diçka. Jo-ja nuk besoj se do të realizohet vetëm nëse fondi shtyhet dhe deri në muajin Qershor që do të vij Validimi ne jemi në rrezik. Kështu që duhet tani të gjithë të mendojmë se çfarë

mund të bëjmë. Z. Tërpo ka bërë punën e duhur dhe siç e di edhe vetë tha ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme duke punuar që të fitohet kohë. Unë di edhe këtë tjetër, gjë të cilën ne e kemi hasur çdo vit, institucionet nuk përgjigjen në kohë për të gjithë informacionin që duhet të japin Administratorit dhe për këtë arsye Raportet janë vonuar shumë. Atëhere, çfarë masash duhet të marrim ne ose çfarë kërkesë apo urdhëri duhet të dalë nga ana jonë. Dikur praktika ka qënë që merrnim vendim në MSG dhe Kryetari MSG-së bënte një letër dërguar të gjithë Ministrave dhe ata jepnin urdhër të gjithë Institucioneve përkatëse që ata të përgjigjeshin. Atëhere, të ulemi dhe të hartojmë një dokument ku ti shkoj edhe Kryeministrit dhe vetë Kryeministri ti japi urdhër Ministrave që të bëhet sa më shpejtë. Nuk kemi kohë, nuk kemi një vit por kemi vetëm tre muaj kohë për Raportet.

**Z. GENCI TËRPO** Ne besojmë dhe jemi të bindur që do të kemi mundësi ti vazhdojmë të gjitha aktivitetet që janë planifikuar deri në fund të vitit sepse fondi i Bankës Botërore besojmë se ka për tu shtyrë dhe natyrisht më pas që të punojmë pak me kohën në kuptimin e shpejtësisë sepse nëse një aktivitet më parë mund të bëhej në një vit, tani do ta bëjmë për 6 muaj.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Unë kam hallin se në muajin Qershor kemi Validimin dhe duhet të bëjmë sa më shumë të jetë e mundur.

**Z. GENCI TËRPO** Besoj se deri në fillimin e procesit të Validimit ne do jemi në gjysmën e punës me BO-në. Natyrisht që kjo veprimtari është risi për ne sepse nuk është bërë ndonjëherë por Standarti e kërkon që të bëhet dhe vetë MSG-ja është pjesë e rëndësishme në këtë proces.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** E uroj këtë gjë! Por them çfarë masash duhet të marrim që institucionet tona të përgjigjen.

**Z. LLUKA GJERGO** Znj. Hajnaj, ju lutem t'ju sqaroj. Në kontratën që u lidh me Administratorin e Pavarur që do të jetë përsëri kompania Deloitte, që ka qënë



edhe më parë, gjë e cila është pozitive pasi e njeh natyrën e Raportit dhe ka një numër të mirë të kontakteve dhe me institucionet gjithashtu. Ajo letër që drejtohet në emër të Kryetarit të MSG-së, është gati dhe e ripunuar për tu dërguar. Edhe me kompanitë, që është përcaktuar lista, realisht sipas hapave të Raportit, si fazë përgatitore në emër të Sekretariatit unë kam nisur email-e, të gjitha kompanive, për ato mineraret, i përfundova sot. Të gjitha kompanive i është kërkuar të përcaktojnë një person kontakti i cili do të merret me Raportin EITI. Një pjesë, jo e madhe kanë kthyer përgjigje dhe e kanë përcaktuar personin. Ndërkohë një pjesë tjetër, kanë ndërruar adresat e email-it dhe ngelet të punojmë përsëri për ti rifreskuar. Fryma tek ne dhe tek Administratori është e tillë që në fund të mujit Prill të bëjmë të pamundurën për ta realizuar. Me Institucionet është biseduar që krahas letrës, siç dihet që letrat ngelin jo pak herë në sirtare, pasi kanë edhe punët e tyre, është biseduar edhe me Drejtuesin z. Tërpo edhe me Koordinatorin që do të jetë nga Deloitte me ato pikat të cilat është hasur vështirësi duke ndjekur modelin që me Drejtoreshën e Tatimeve, duke qënë se aty është volumi edhe më i madh, të organizohet një takim dhe ku Drejtuesja të angazhoj linjat që do të merren me Raportin. Me Albpetrolin që edhe ai ka qënë problematik është menduar dhe vendosur të organizohet një takim me Drejtuesin. Krahas shkresës që do shkoj në rrugë zyrtare dhe organizimi i një takimi ballë për ballë duke paraqitur kërkesat mendoj që do të jetë shumë rezultativ duke ndihmuar edhe Deloitte dhe ne si Sekretariat.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Shumë mirë!

**Z. LLUKA GJERGO** Siç ju e dini ne i filluam përgatitjet për Raportin dhe më pas ngelëm në vend dhe informacioni nga Doganat është marrë, Administratori po punon. Për kompanitë, nga AKBN informacioni është marrë dhe i është dërguar Administratorit.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Për të dyja vitet?

**Z. LLUKA GJERGO** Po, për të dyja vitet 2017-2018 dhe do të ecet paralelisht.

**Z. GENCI TËRPO** E thënë ndryshe të gjitha aktivitetet deri në fund të vitit do të realizohen nuk do të ngelet asgjë pa bërë. Jemi duke pritur disa mekanizma që duhen të realizohen. Ju lutem, kalojmë me radhë çështjet e rendit të ditës. Pika e parë, diskutim dhe vendimmarrje për hapat që do të ndiqen për Corrective Actions të dala nga Misioni i II i Validimit dhe masat që duhen marrë për realizimin e tyre. Besoj ju e keni marrë materialin dhe jeni të lirë të shprehni mendimet tuaja për sa i takon kësaj çështje.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Të flas unë për shoqërinë civile, sepse është dhe pjesa më e ndjeshme të cilën e kemi pasur problem. Ne kemi pasur mbështetje për gjithë ecurinë tonë edhe për rritjen e kapaciteteve nga SECO, Ambasada Zviceriane. Është bërë një studim i cili ka përfunduar dhe do ta ndaj edhe me ju, një sondazh sesa njihet EITI në tërësi nga popullsia. Ne kishim financim vetëm në 5 rrethe por duke qënë se unë fitova një projekt nga Lëviz Albania për rentën minerare, e vazhdova studimin edhe në qytete të tjera dhe në total janë mbuluar 10 rrethe. Përfundimet e sondazhit do ju dërgohen edhe juve dhe bazuar në këtë sondazh ne do të bëjmë trajnimin e shoqërisë civile sepse kemi rritjen e kapaciteteve dhe zgjerimin e shoqërisë civile dhe të aktorëve të ndryshëm në 5 rrethe. Sepse e kemi vetëm për pesë rrethe, sepse rrethet e tjera pothuajse kanë përfunduar sepse bashkë me rentën kemi bërë edhe promovim të EITI. Këto aktivitete do të kryhen duke filluar që javës tjetër dhe shpresojmë në muajin Mars do të kemi një takim Kombëtar me anëtarë të shoqërisë civile por njëkohësisht do të ftohen edhe nga Sekretariati, Ministria, Ambasada Zviceriane, të gjithë Drejtuesit e MSG-së, që të njihet i gjithë procesi i EITI-it. Shpresojmë që me këtë i plotësojmë sepse edhe gjatë vitit të kaluar kemi bërë monitorimin e rentës dhe njëkohësisht sondazh sesa njihet renta nga popullsitë vendase dhe mendojë se ne e realizojmë atë çka na kërkohet nga Validimi, nga Corrective Actions.

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Unë kisha vetëm një kërkesë, ku të gjitha këto aktivitete që ju si shoqëri civile bëni, ju lutem ruajini linqet e çka ju publikoni, si aktivitete, foto

gjithashtu etj., ruajini në një folder ose krijoni dhe një folder të përbashkët që kur të vij Validimi ti kemi gati.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Po, i kemi të gjitha në faqen e web-it. Ne kemi ndërmarrë edhe një iniciativë tjetër që për 'fee' konçensionare të aplikohet e njëjta gjë si për rentën minerare. Është një iniciativë që ne e kemi nisur tashmë dhe e kemi bërë dhe publike ku janë organizuar edhe intervista.

**Z. PËRPARIM ALIKAJ** Ne do raportojmë sa kompani kemi dhe sa po na mbeten. Sepse kompanitë e vogla nuk kanë potencial. Si rasti kur në dhjetor, u rrit renta minerare dhe u propozua 3% për kompanitë që nuk e çonin në përpunim minerari. Shkonte nga 6 në 9 dhe u bë shumë luftë për... dhe u bë 7%. Tani nuk ka kapacitet përpunues, po ku do ta çojnë këtë minerar, ku dhe çmimet janë shumë të larta.

**Z. LLUKA GJERGO** Përparim, ju e dini që ka qënë një komision ad-hoc në përcaktimin e rentës dhe ky komision nuk ekziston më.

**Z. PËRPARIM ALIKAJ** Unë e ngre këtë shqetësim se nëse themi nuk po hyjnë kompani të huaja është pikërisht prej kësaj gjëje

**Z. GENCI TËRPO** Atëhere për sa i përket pikave të Corrective Actions, mendoni që duhet të diskutojmë ndonjë gjë tjetër për sa i përket atyre çfarë kanë dalë nga Validimi i II-të? Apo jemi dakort me ato?

**Z. LLUKA GJERGO** Ka qënë dhe kërkesë nga Oslo që përfaqësuesi nga Albpetrol duhet të jetë vendimmarrës

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Po dhe ne e kemi kërkuar, po ju e dini që në Urdhërin e Kryeministrit nuk e kemi si institucion vendimmarrës në listën e institucioneve. Ne kemi kërkuar që të ndryshohet Urdhëri i Kryeministrit për MSG. Vjet u morë masa që futëm Albpetrol dhe bëmë një lëvizje që ta kishim Albpetrolin rol dhe ata e kanë caktuar personin i cili nuk ka ardhur ndonjëherë në mbledhje dhe këtu

qëndron çështja. Duhet bërë një propozim se si duhet pasi erdhi Validimi dhe nuk kemi kohë

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Të bëhet me Urdhër Ministri që ata të marrin pjesë gjithmonë. Albpetroli ta ketë detyrim të vij këtu dhe të përgjigjet.

**Z. LLUKA GJERGO** Një shkresë e dalë nga Ministri dhe nuk besoj se ata do ta neglizhojnë

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Po një shkresë e dalë nga Ministri

**Z. PËRPARIM ALIKAJ** Sepse dhe kjo pikë lidhet direkt me Albpetrol

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Të marrim një vendim që Ministri të detyroj një nga përfaqësuesit e Albpetrol të marrin pjesë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Në lidhje me Corrective Actions pika 3

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Po dhe të jenë këtu sa herë të kemi mbledhje

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Kaluam te pika 3 direkt por është pika 2 njëherë, transferimi i liçensave

**Z. LLUKA GJERGO** Për ta sqaruar si problem, transferimi dhe dhënia e liçensave bëhet në bazë të ligjit minerar që në një fare mënyre është ekzistent dhe jo i keq për dhënien. Vetëm se e meta më e madhe është se ne ato veprime nuk i bëjmë publike. Po të hysh në faqen e Ministrisë nuk gjen asnjë lloj informacioni përsa i përket dhënies apo transferimit të liçensave. Realisht bëhen nëpërmjet APP-së e cila është një praktikë shumë e mirë por shoqëria apo më tepër që do të hyj te faqja e APP-së ...nëse e publikon dhe faqja e Ministrisë plotësohet shumë mirë dhe pika e dytë sepse realisht bëhet, shpallet procedura për leje minerare, vijnë marrin dokumentacionin, vijnë dhe aplikojnë të interesuarit.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Po tek faqja e AKBN-së është?

**Z. LLUKA GJERGO** Jo, nuk është detyra e AKBN-së e cila merret me pjesën teknike dhe kur e plotëson ja sjell Ministrisë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Po për naftën?

**Z. LLUKA GJERGO** Për naftën, ajo praktikë që ndiqet Shqipëria i ka shpallur zonat e lira të vetat dhe kush ka interes nga kompanitë e huaja është i mirëpritur

**Z. PËRPARIM ALIKAJ** Edhe këtu duhet më shumë transparencë dhe azhurnim çdo muaj

**Z. LLUKA GJERGO** Patjetër

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Asnjë nuk bën azhurnim, a e besoni ju që Ministria ka akoma vendimin me 25% të rentës të 2009-2011. Ndërkohë te faqja e AKBN-së nuk gjendet asnjë gjë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Kur erdhi Validimi i II-të, Unë, Lluka dhe Arlinda kemi bërë një punë jo të vogël në website-in tonë dhe nuk e di në i keni parë ndryshimet, kemi vendosur bazën ligjore. Gjatë Validimit të II është hedhur informacion për bazën ligjore, kontratat që janë nënshkruar, VKM-të që kanë dalë etj. si në sektorin hidrokarbur ashtu dhe në atë minerar. Do ishte mirë që të gjitha këto informacione të ishin në një vënd si në website-in e Ministrisë ndoshta apo institucioneve përkatëse.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Të gjitha duhet ti kenë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Ju çfarë propozoni që mund të bëjmë në lidhje me këtë?

**Z. ROBERT BESHELLO** Kush është i interesuari apo i ngarkuari për të dhënë liçensat ai ...

**ZNJ. OLA MITRE** Një regjistër unik

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Seç është një regjistër te Ministria por aty nuk ka kush të dojë akses, në mos gabo. Të bëhet publik.

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Na jepni ju një zgjidhje si ju mendoni

**ZNJ. OLA MITRE** Nuk është se ne duhet të propozojmë diçka konkrete, ata e kanë detyrim ti kenë publike. Duhet ti dërgohet një shkeresë që të zbatohet detyrimi për ti bërë publike

Flasin disa anëtarë në të njëjtën kohë

**Z. GENCI TËRPO** Ju lutem çfarë do të vendosim për këtë pikë

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Që të ushtrohet presion mbi institucionet e tjera me një Urdhër nga Ministritë përkatëse

**ZNJ. OLA MITRE** Të zbatojnë detyrimin që kanë për ti bërë të dhënat publike

**Z. GENCI TËRPO** Mendoni që shkresa të bëhet nga MIE apo nga MSG-ja?

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Ne ja bëjmë Ministres

**Z. GENCI TËRPO** Më kuptoni, ne jemi institucion dhe si i tillë duhet të mbajmë një qëndrim konform ligjit dhe kërkesave të standardit EITI. Dhe ajo çka diskutojmë këtu të jetë e tillë. Nuk mund të dalim jashtë kërkesave. Ne mund të sugjerojmë dhe mendoj që vetëm mund të sugjerojmë në këtë rast. MSG nuk urdhëron organet e prora.

**ZNJ. OLA MITRE** Unë them ta lëmë në dorë të Ministres të zgjedhë mënyrën se si ajo do ta bëjë këtë gjë.

**Z. PËRPARIM ALIKAJ** Ne ja sygjerojmë

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Ku i themi në bazë të detyrimeve që kemi duhet bërë kjo gjë

**ZNJ. OLA MITRE** Mund ti bëhet parasysh edhe penalizimet që ne kemi nëse kjo nuk bëhet

**Z. GENCI TËRPO** Tjetër për sa i takon kësaj pike , ju lutem vendosni.

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Për pikën tre, si u la

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Të japi Urdhër për Albpetrolin që të ketë një përfaqësues në tryezën e MSG-së dhe urdhërin ta bëjmë nga Ministri kësaj radhe dhe jo nga Zëvendësministri

Flasin disa anëtarë në të njëjtën kohë

**Z. GENCI TËRPO** Atëhere çfarë do të vendosim për këtë pikë. Vendimarrja të jetë në përputhje me aq sa lejohet. Në këtë rast mund të sugjerojmë.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Unë nuk e di se ku qëndron ngërçi me Albpetrolin sepse unë kam biseduar me nënkryetaren e Bashkisë e Fierit dhe ajo më siguroi që i gjithë informacioni është. Atëhere pse Albpetroli nuk e jep kur e kanë të gjithë?

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Ti e di shumë mirë se sa herë i është kërkuar Albpetrolit dhe ju ishit prezent për Commodity Trading se si shkoi që i është kërkuar vazhdimisht informacion si nga ana jonë ashtu edhe nga ana e Deloitte dhe në përfundim dështoi si projekt sepse nuk erdhi informacioni. Kanë qënë edhe anëtarët e Albpetrol në takim që u bë tek Sheraton, nëse e mbani mend, për Commodity Trading ku morën përsipër që do e nisnin informacionin dhe nuk u nis asnjë lloj informacioni

**Z. GENCI TËRPO** Atëhere pas diskutimit Tuaj çfarë do të vendosim? Merrni vendim ju lutem

**ZNJ. OLA MITRE** Kjo mund të bëhet një shkresë e unifikuar tek të dyja sepse pak a shumë jemi me të njëjtat kërkesa dhe tek shkresa që do të dërgohet të jetë dhe pjesa e Albpetrolit

**Z. GENCI TËRPO** Pika e katërt

**Z. PËRPARIM ALIKAJ** Ky i...është pak problem se si rezultat edhe i uljeve të çmimeve të minerareve dhe sa vjen niveli i kompanive që janë poshtë pragut që është vendosur të shtohet sepse ka rënë çmimi i minerareve dhe nuk nxjerrin më shumë minerare nga çfarë nxirrin më parë...

Flasin disa anëtarë në të njëjtën kohë

**Z. LLUKA GJERGO** Kjo që thotë z. Alikaj niveli i kompanive është i ulët për Raportin 2017-2018 si bazë për përzgjedhjen e kompanive minerare, se në naftë raportojnë të gjitha, në hidroenergji janë 15 kompani që kapin rreth 90%-91% të prodhimit të vendit edhe tek mineraret ka qënë objekti të mbulohen 91% e prodhimit në industrinë minerare. Është rritur numri i kompanive që do të raportojnë, ka shkuar 138 kompani që janë i njëjti numër edhe për vitin 2017-2018. Kapet rreth 91% e prodhimit të realizuar. Janë përzgjedhur kompani sipas minerareve, kryesisht peshën dërmuese e zë Kromi dhe gëlqerorët, materialet e ndërtimit. Si leje minerare janë më tepër, për vitin 2017 janë dy kompani në fushën e zbulimit dhe në 2018 janë tre kompani siç janë marrë nga Shërbimi Gjeologjik që edhe ato raportojnë. Lista është përzgjedhur ...kjo është bërë mbi bazën e informacionit të marrë nga AKBN-ja. Jemi munduar që si referencë për zgjedhjen e kompanive të jetë volumi i prodhimit të tyre. Është vendosur dyshemeja 150.000\$, e cila është ulur shumë po ta mendosh me vitet e mëparshme. Kur ka filluar EITI si Standart ka qënë 700.000\$ dhe ky prag është ulur vetëm për të patur sa më shumë përfaqësim të industrisë minerare. Krahas punës sonë dhe krahas punës së Deloitte ajo që vitin e kaluar ka dhënë rezultat ka qënë ndërhyrja e Ministrisë dhe Drejtorisë Minerare. Për këtë vit siç edhe ju informova, i kam dërguar email të gjitha kompanive, në adresat që kam marrë nga AKBN-ja dhe ato nga QKB-ja. Shpresoj që ky proces të eci.

**ZNJ. OLA MITRE** Ju lutem, mund të bëj një ndërhyrje meqë jemi tek kompanitë që janë përzgjedhur dhe po shikoj Projekt Vendimin që ka bërë gati Emiliana dhe ku thuhet thjesht si numra 10 kompani, 15 kompani nga hidroenergji dhe me rradhë por do sygjeroja që të shtohet edhe një shtojcë në këtë Vendim me të gjithë emrat e kompanive që janë përzgjedhur të jenë subjekt i raportimit

**Z. LLUKA GJERGO** Patjetër

**ZNJ. OLA MITRE** Duke u saktësuar sipas shtojcës bashkëlidhur lista



**Z. LLUKA GJERGO** Deloitte si Administrator i Pavarur realisht..

**ZNJ. OLA MITRE** Ka dhe një problem me raportet e mëparshme me Deloitte sepse Deloitte raporton që x kompani, vetëm si numër, nuk kanë pranuar të raportojnë por nuk bënë publik emrat e kompanive që refuzojnë të japin informacion

**Z. LLUKA GJERGO** Në raport përmenden si kompani

**ZNJ. OLA MITRE** Thuhen si emra, specifikohen?

**Z. LLUKA GJERGO** Po dhe thuhet kjo kompani nuk ka raportuar

**ZNJ. OLA MITRE** OK! Edhe diçka, Raportimi sipas Standartit EITI është detyrim ligjor nga kompanitë. Çfarë masash merren ndaj këtyre kompanive që nuk raportojnë? MSG-ja e mëparshme ka pasur disa plane që penalizimi të shkonte deri në heqjen e liçensave

**Z. LLUKA GJERGO** Realisht në draft ligjin EITI është parashikuar

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Për të shtuar, në letrat që i dërgohen Bizneseve apo Institucioneve; a është përcaktuar një 'deadline' se deri kur duhet kthyer përgjigje?

**Z. LLUKA GJERGO** Po, patjetër

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Nëse ka 'deadline' Deloitte duhet t'ju informoj juve si Sekretariat por edhe neve që informacioni nuk ka ardhur për të evituar vonesat pasi nuk kemi kohë

**Z. LLUKA GJERGO** Në negociatat që u bënë me Deloitte, ju bë e ditur situata ku ne jemi aktualisht dhe se koha është shumë e shkurtër. Ata i njohin problematikat dhe se ku qëndrojnë vështirësitë për realizimin e Raportit.

**Z. GENCI TËRPO** Çfarë vendosni për këtë pikë?

**Z. LLUKA GJERGO** Krahës punës së Deloitte dhe Sekretariatit duhet edhe suporti i Ministrisë dhe AKBN-së

**Z. GENCI TËRPO** Ju lutem të vazhdojmë me pikat

**Z. PËRPARIM ALIKAJ** Pika e 5-stë është e realizueshme, sepse edhe kompanitë kanë interes të deklarojnë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Çfarë ju propozoni konkretisht?

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Ku është problemi i pikës 5-së se nuk po e kuptoj?

**Z. LLUKA GJERGO** Është ajo që ju e keni bërë me pushtetin lokal

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Unë i kam thënë pushtetit lokal dhe asnjë nuk e ka bërë deri më tani dhe duhet të bëhet presion pushtetit lokal .

Flasin disa anëtarë në të njëjtën kohë

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Shoqatës së Bashkive ti drejtohet një letër dhe ku ti kërkohet që të gjitha Bashkitë të publikojnë taksat që marrin nga shfrytëzimi i burimeve natyrore dhe ku i investojnë. Bashkitë kanë në faqet e tyre të internetit planin e investimit dhe të gjithë buxhetin. Unë kam kërkuar që ata të bëjnë një listë të të gjithë kompanive që kanë në bashkitë e tyre dhe të publikojnë çfarë taksash marrin nga këto kompani, sa rent dhe se ku shpenzohet. Deri tani nuk e ka bërë asnjë.

**Z. GENCI TËRPO** Ju lutem si do vendosni?

**ZNJ. OLA MITRE** Ti bëhet shkresë Bashkive

Flasin disa anëtarë në të njëjtën kohë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Sygjeroni që shkresa të dali nga MSG-ja?

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Po nga MSG-ja

**Z. SAMI NEZA** Nga MSG-ja

**Z. LLUKA GJERGO** Për pikën e radhës, informacioni merret nga kompanitë, nga institucionet shtetërore, merret nga Drejtoria e Tatimeve dhe Doganave dhe ky informacion kryqëzohet dhe aty ku ka mospërputhje kërkohet të sqarohet pse është kjo diferencë. Dhe realisht, pas analizës del një rezultat më se i saktë. Ajo që kërkohet është që informacioni që jepet nga kompanitë duhet të firmoset nga ekspertët e pavarur.

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Jo nuk kërkohet kjo gjë Lluka dhe këtu ka pasur një keqkuptim. Kur erdhën Validuesit ata u shprehën se nuk e kërkonin këtë gjë dhe nuk e kanë kërkuar ndonjëherë. Oslo duke parë rolin e lartë që ka Kontrolli i Lartë i Shtetit në vendet e tjeta ka kërkuar të përfshihet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Po edhe unë kujtoj që është diskutuar kjo gjë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Por, Kontrolli ynë i Lartë i Shtetit nuk e ka në 'scop-in' e saj të punës pjesën e kontrollit të privatit. Edhe pse ne jua kemi shpjeguar vazhdimisht këtë gjë ata kanë kërkuar të takohen me Kontrollin e Lartë të Shtetit

**ZNJ. OLA MITRE** Të nisë puna për ngritjen e një institucioni të ngjashëm me Kontrollin e Lartë të Shtetit por kjo kërkon shumë angazhim serioz.

**Z. LLUKA GJERGO** Ministria apo edhe AKBN-ja kontrollohen nga KLSH-ja, dhe sygjerohet që konkluzionet që dalin nga KLSH-ja gjatë kontrollit, të merren nga Administratori, i cili ti trajtojë dhe ti përfshijë në Raport. Por në Termat e Referencës të këtij Raporti që po përgatitet kjo kërkesë nuk është dhënë.

Flasin disa anëtarë në të njëjtën kohë

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Ne do të Validohemi me Raportin që po bëhet aktualisht pra duhet gjetur një zgjidhje aktuale, jo ajo afatgjatë.

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Mund të ofroj informacionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Ministria dhe AKBN-ja, pasi ata i kanë. Të ofrohet nga Ministria dhe AKBN-ja dhe

ne jemi në rregull. Institucionet duhet të ofrojnë dokumentacionin që ka bërë Kontrolli i Lartë i Shtetit në lidhje

**ZNJ. EMILIANA KOLA** Nuk kërkohet vetëm për Institucionet, kërkohet për informacionin financiar të ofruar nga kompanitë

Flasin disa anëtarë në të njëjtën kohë

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Nga kompanitë nuk kërkohet, ndërkohë institucionet duhet të japin raportin e KLSH-së, si AKBN-ja, si Ministria

**Z. GENCI TËRPO** Këtu ka dhe diçka që kontrolli i Lartë i Shtetit nuk shkon çdo 6 muaj dhe ka plane specifike pune shpeshherë në kontrole. Kjo nuk mund të kërkohet kjo gjë. Lidhur me Planin e Punës keni ndonjë kundërshtim? Atëherë jemi dakord.

**ZNJ. OLA MITRE** Në lidhje me të dhënat e hapura, pika 3. Është shumë standarte, “krijimi i të dhënave të hapura për EITI-tin, në sistemet qeveritare për të siguruar afatet kohore, cilësitë e të dhënave, ripërdorim dhe efektivitet në kosto” si do bëhet kjo?

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Të gjitha ato çfarë thamë deri tani, plotësojnë këtë.

**ZNJ. OLA MITRE** Pra kjo do realizohet duke bërë të gjitha shkresat

**ZNJ. ANILA HAJNAJ** Po, të gjitha çfarë u thanë

**ZNJ. ANISA DEDA** Në Planin e Punës janë ‘update-uar’ vetëm afatet sepse shumë aktivitete gjatë vitit 2019 nuk u realizuan për arsye që ju i dini. Pra ne thjesht i kemi spostuar për vitin 2020 duke ‘update-uar’ kohën e implementimit dhe nuk ka asnjë ndryshim apo aktivitete të reja.

**Z. GENCI TËRPO** Jeni dakort me Planin e Punës?

Anëtarët e MSG-së bien një zëri dakort me Planin e Punës. Ok miratohet!

**Z. GENCI TËRPO** Faleminderit! Mbledhjen e MSG-së e deklaroj të mbyllur.

**Mbyllet mbledhja 01:25:50'**